CAME
MORE THAN TECHNOLOGY

MORE THAN 50+ YEARS



BXV - BXV PLUS

Performancë e lartë për mjedise banimi dhe industriale.



BXV është automatizim shumë efikas për porta banimi, i projektuar për nevojat e shtëpive të vogla, pallateve të mëdha dhe kompleksëve industriale.

BXV
KARAKTERISTIKAT

• 7 MODELE TË DISPONUESHME
Gama përfshin edhe versionin Rapid me shpejtësi deri në 22 m/min dhe 3 modele shtesë në versionin PLUS.

• TESTUAR PËR PËRDORIM INTENSIV
Për porta rrëshqitëse deri në 1000 kg dhe 20 m.

• MOTOR 24 V DC
Me enkoder, për kontroll të saktë të ngadalësimit dhe performancë më të mirë.

• PLLAKA E KOMANDIMIT
Terminale të veçanta me ngjyra, për të thjeshtuar montimin.

• EKRAN SINJALIZIMI
Thjeshton konfigurimin dhe mirëmbajtjen.

• SISTEM ZHBLLOKIMI
Përdorim i lehtë për hapjen manuale të portës.

VERSIONI PLUS ME ELEKTRONIKË TË AVANCUAR PËR INSTALIME NË MJEDISE INDUSTRIALE



Seria BXV PLUS ka pllakë të avancuar me ekran grafik dhe konfigurim automatik për programim më të thjeshtë. Konektori CXN BUS mundëson lidhjen e gamës së aksesorëve BUS. Teknologjia Adaptive Speed & Torque siguron performancë të lartë dhe lëvizje të buta e të rrjedhshme.
Funksioni i orës së integruar, i përfshirë si standard, lejon administrim praktik të hapjes dhe mbylljes automatike.



FUNKSIONE TË AVANCUARA

• DEKODIM RADIO I INTEGRUAR ROLLING CODE DHE KEY CODE (TWIN), për administrimin e deri në 250 përdoruesve.

• MEMORY ROLL për ruajtjen dhe transferimin e konfigurimeve dhe të dhënave të përdoruesve të regjistruar.

• Përputhet me CAME KEY për programim dhe konfigurim të avancuar nga telefoni ose tableti.

• Përputhet me TEKNOLOGJINË CAME CONNECT për administrim të avancuar dhe kontroll në distancë të sistemit.

• I përgatitur për FUNDORE MAGNETIKE DHE NGROHËS, për t'u përshtatur me çdo klimë.

Kapaku i posaçëm i pllakës së komandimit siguron më shumë mbrojtje pa ngadalësuar programimin.




Dizajn elegant, fuqi
dhe besueshmëri: BXV,
zgjidhja ideale për
çdo mjedis banimi.

FUNKSIONE TË AVANCUARA TË PLLAKËS SË KOMANDIMIT

Pllaka e komandimit ZN7 vendoset horizontalisht për qasje të lehtë dhe më shumë hapësirë për aksesorët.

SISTEMI RIO
Teknologjia pa tela e CAME për montimin e të gjitha pajisjeve të komandimit dhe sigurisë përmes lidhjeve pa tela, pa nevojë për kabllo.


SELEKTORË TRANSPONDER DHE ME TASTIERË
Lidhen drejtpërdrejt me pllakën e komandimit përmes aksesorëve R800.

MODULI GREEN POWER
Siguron përputhjen e gamës BXV me RREGULLOREN (BE) 2023/826.

MODULI RSE
Për funksionim të çiftuar, mundëson montimin dhe konfigurimin e lehtë të dy automatizimeve me funksionin master/slave.

BATERI EMERGJENCE
Sigurojnë funksionim të saktë edhe kur ndërpritet energjia elektrike.

KONFIGURIMI I DREJTIMIT TË HAPJES
Funksion i shpejtë në ekran, pa pasur nevojë të ndryshohen lidhjet e motorit.



CAME KEY



MJETI JUAJ I RI I PUNËS.

Konfigurimi dhe montimi i një sistemi kërkon kohë dhe shpesh kryhet në pozicione të parehatshme, si p.sh. në gjunjë nën shi.

Lëreni kaçavidën në kutinë e veglave dhe filloni të përdorni një mjet të brezit të ri.
CAME KEY është ndërfaqe Wi-Fi që komunikon me çdo telefon ose tablet pa pasur nevojë për lidhje interneti.

Lidhni CAME KEY me pllakën e komandimit.

- Konfigurim të shpejtë të automatizimit
- Përditësim të firmuerit të pllakës
- Administrim të telekomandave
- Kopje rezervë të konfigurimeve, lokalisht dhe në cloud

dhe shumë më tepër!



CAME CONNECT
PROVONI QË SOT TEKNOLOGJINË E SË ARDHMES PËR BIZNESIN TUAJ


CAME CONNECT
CLOUD CONNECTED TECHNOLOGY

CAME CONNECT është sistemi cloud që ju lejon të administroni në distancë të gjithë klientët dhe çdo instalim, nga pajisja celulare ose kompjuteri në zyrë.


Të gjitha produktet mund të lidhen me internetin në një rrjet universal, të sigurt dhe të certifikuar nga CAME përmes Gateway, që montohet bashkë me automatizimin.
Nga videointerfonia te kontrolli i ngrohjes, shtëpia inteligjente, motorët e portave, barrierat dhe sistemet e parkimit, të gjitha automatizimet lidhen me njëra-tjetrën dhe administrohen nga një pajisje e vetme. Kjo mundëson kontroll në distancë, diagnostikim të plotë dhe monitorim të defekteve.
Me CAME CONNECT mund të zgjeroni biznesin duke ofruar mirëmbajtje efikase e të vazhdueshme, asistencë në distancë dhe ndërhyrje të shpejtë në rast defekti.
Duke hyrë në platformë si “Përdorues profesionist”, instaluesi ka qasje në shumë funksione të reja:


- Shikimi i instalimeve të klientëve në hartë, me tregues të gjendjes (funksionim i saktë/defekt)
- Lista e plotë e automatizimeve për çdo klient, me treguesit e gjendjes
- Konfigurimi dhe monitorimi i të gjitha pajisjeve të lidhura
- Administrimi i skenarëve dhe planifikimi i veprimeve
- Kontrolli i historikut dhe gjendjes
- Administrimi i mirëmbajtjes së planifikuar për çdo pajisje

Duke hyrë si “Përdorues privat”, CAME CONNECT është zgjidhje ideale edhe për përdoruesin përfundimtar që dëshiron të administrojë në distancë teknologjitë e shtëpisë, të aktivizojë automatizimet, të shohë pamjet e sistemit të sigurisë, të marrë njoftime ose t’i dërgojë instaluesit kërkesa për asistencë.



GAMA E PLOTË





* 801MS-0160 - 801MS-0190 - 801MS-0250 seria BXV
* 801MS-0570 - 801MS-0580 - 801MS-0590 seria BXV PLUS

KUFIJTË E PËRDORIMIT

	BXV							BXV PLUS		
MODELET	801MS-0150	801MS-0180	801MS-0210	801MS-0230	801MS-0160	801MS-0190	801MS-0250	801MS-0570	801MS-0580	801MS-0590
Pesha maks. e kanatit (kg)	400	600	800	1000	400	600	1000	400	600	1000
Moduli i pinionit	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4

LLOJI I BATERISË (nuk përfshihet)

MODELET	801MS-0150	801MS-0180	801MS-0210	801MS-0230	801MS-0160	801MS-0190	801MS-0250	801MS-0570	801MS-0580	801MS-0590
Sasia dhe lloji	2x 2 V - 1.3 Ah	2x12 V - 5 Ah	2x12 V - 1.3 Ah	2x12 V - 5 Ah	2x12 V - 1.3 Ah	2x 2 V - 1.3 Ah	2x12 V - 5 Ah	2x12 V - 5 Ah	2x12 V - 5 Ah	2x12 V - 5 Ah

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

MODELET	801MS-0150	801MS-0180	801MS-0210	801MS-0230	801MS-0160	801MS-0190	801MS-0250	801MS-0570	801MS-0580	801MS-0590
Shkalla e mbrojtjes (IP)	54	54	54	54	54	54	54	54	54	54
Furnizimi (V AC - 50/60 Hz)	230	230	230	230	230	230	230	230	230	230
Furnizimi i motorit (V DC)	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24
Rryma maksimale (A)	7	11	16	16	10	10	16	7	11	16
Fuqia (W)	170	270	400	400	240	240	360	170	270	400
Shpejtësia e lëvizjes (m/min)	12	12	11	11	22	20	20	12	12	11
Cikle/orë	PËRDORIM INTENSIV	PËRDORIM INTENSIV	PËRDORIM INTENSIV	PËRDORIM INTENSIV	PËRDORIM INTENSIV	PËRDORIM INTENSIV	PËRDORIM INTENSIV	PËRDORIM INTENSIV	PËRDORIM INTENSIV	PËRDORIM INTENSIV
Forca shtytëse (N)	350	600	800	1000	250	330	450	350	600	1000
Temperatura e punës (°C)	-20 deri +55	-20 deri +55	-20 deri +55	-20 deri +55	-20 deri +55	-20 deri +55	-20 deri +55	-20 deri +55	-20 deri +55	-20 deri +55

● 24 V DC

ADI PROFESSIONAL
Engineering Smart Access

BXV - BXV PLUS

AUTOMATIZIM PËR PORTA RRËSHQITËSE

Porta deri në 1000 kg dhe 20 m
Motor 24 V DC me enkoder
Shpejtësi deri në 22 m/min

ADI PROFESSIONAL

Rruga Butrinti nr. 9
Kashar, Tiranë

info@adiprofessional.al

CE